



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2391/3 Prot.

Rrëshen më, 04 . 08 . 2020

V E N D I M

Nr. 78 datë 03.08.2020

PËR

“MIRATIMIN E RIKONSTRUKSIONIT, ZGJERIMIT TË RRUGËS EKZISTUESE AUTOMOBILISTKE, NË LAGJEN “GEG KOLAJ”, FSHATI RREJA E VELËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE RUBIK, 4603, BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 6, gërma “i”, të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, (të ndryshuar), dhe projekt-vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë (drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak në seancë;

V E N D O S I :

1. Miratimin e rikonstruksionit, zgjerimit të rrugës ekzistuese automobilistike në lagjen “Geg Kolaj” fshati Rreja e Velës, njësia administrative Rubik, 4603, bashkia Mirditë.
 - Segmenti i rrugës, me gjatësi $L = 414$ m, gjërësi kaluese 3.5 m, ZK. 3220 dhe me nr.pasurie 5/5, volum 2, faqe215.
2. Bashkëlidhur, raporti teknik, plan vendosja shk.1:5 000, planimetria shk.1:5 000, pjesë e këtij vendimi.
3. Punimet për rikonstruksionin e rrugës automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zonës.
4. Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe prone e bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë.

5. Ngarkohet kryetari i bashkisë, (drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit, njësia administrative Rubik) për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"(të ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gasper TOPOLLAJ



KRYETAR

Pjeter PJETRI

